



Pranuar / Dorezuar Primiemo/Prodato Received/Deliverty	15.04.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	2167/2022		114

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.210/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.210/2021 të datës 04.03.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë

Komuna e Prishtinës , kundër organit të punësimit/ Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike “vlerësim i punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 15.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.210/2022, e datës 04.03.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Drejtësisë ,sipas akt emërimit të datës 12.01.2018, në pozitën “Zyrtare Ligjore” ne Divizionin për bashkëpunim ne çështje civile dhe penale pranë Departamentit për bashkëpunim ndërkombëtar juridik. Udhëheqësja e Divizionit për Bashkëpunim në Çështjet Penale dhe Civile në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, me datën 26.01.2022 ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për vitin 2021, duke e vlerësuar të njëjtën lidhur me objektivat e punës me notë mesatare 3 kurse për aftësitë e përgjithshme me notë mesatare 3.3, respektivisht me notën e përgjithshme 3.1, që në kuptim të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike nënkupton vlerësimin “mirë”.

Ankuesja e pakënaqur me këtë vlerësim, me datën 04.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se formulari i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 26.01.2021 është vlerësim jo real, jo objektiv, jo profesional dhe në kundërshtim me Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 10.03.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Drejtësisë . Këshilli me datën 18.03.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Drejtësisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 1190/2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesen i datës 26.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 31.01.2022; Procesverbalin e datës 07.11.2019; Raportin e ekzaminimit mikrobiologjik të datës 20.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 04.11.2019; E-mailin zyrtar të datës 01.11.2019; E-mailin zyrtar të datës 01.11.2019; E-mailin zyrtar të datës 31.10.2019; E-mailin zyrtar të datës 28.12.2018; E-mailin zyrtar të datës 24.12.2018; E-mailin zyrtar të datës 23.12.2018; E-mailin zyrtar të datës 19.12.2018; E-mailin zyrtar të datës 17.12.2018; E-mailin zyrtar të datës 07.11.2019; E-mailin zyrtar të datës 06.11.2019; E-mailin zyrtar të datës 01.11.2019; E-mailin zyrtar të datës 01.11.2019; E-mailin zyrtar të datës 31.10.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 18.03.2022 nga Ministria e Drejtësisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankueses të datës 12.01.2018; E-mailin zyrtar të datës 20.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 19.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 11.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2020 i datës 20.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2018 i datës 31.12.2019; E-mailin zyrtar të datës 06.11.2019; Gjendja aktuale për hyrje daljet për periudhën prej 01.01.2021 deri me 31.12.2021 për ankuesen; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 18.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 30.06.2021; E-mailin zyrtar të datës 15.04.2021; E-mailin zyrtar të datës 15.04.2021; E-mailin zyrtar të datës 15.04.2021; E-mailin zyrtar të datës 29.01.2021; E-mailin zyrtar të datës 28.01.2021; E-mailin zyrtar të datës 27.01.2021; E-mailin zyrtar të datës 27.01.2021; E-mailin zyrtar të datës 27.01.2021; E-mailin zyrtar të datës 10.12.2021; E-mailin zyrtar të datës 24.09.2020; E-mailin zyrtar të datës 14.10.2021; E-mailin zyrtar të datës 11.10.2021; E-mailin zyrtar të datës 24.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 11.10.2021; E-mailin zyrtar të datës 22.06.2021; E-mailin zyrtar të datës 18.05.2021; E-mailin zyrtar të datës 27.04.2021; E-mailin zyrtar të datës 15.04.2021; E-mailin zyrtar të datës 15.04.2021; E-mailin zyrtar të datës 27.04.2021; E-mailin zyrtar të datës 10.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 27.09.2021; E-mailin zyrtar të datës 27.09.2021; Shkresën zyrtare të datës 19.11.2021; Shkresën zyrtare të datës 27.04.2021; Shkresën zyrtare të datës 08.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 08.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 08.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 22.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 24.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 22.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 22.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 01.05.2022; Shkresën zyrtare të datës 12.03.2021; Shkresën zyrtare të datës 03.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 12.03.2021; Shkresën zyrtare të datës 12.03.2021; Shkresën zyrtare të datës 22.04.2021; Shkresën zyrtare të datës 27.04.2021; Shkresën zyrtare të datës

27.04.2021; Shkresën zyrtare të datës 11.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 18.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 18.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 21.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 18.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 02.04.2021; Shkresën zyrtare të datës 27.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 27.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 02.04.2021; Shkresën zyrtare të datës 27.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 27.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 22.04.2021; Shkresën zyrtare të datës 17.01.2022; Shkresën zyrtare të datës 22.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 22.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 01.06.2021; Shkresën zyrtare të datës 25.02.2021; Shkresën zyrtare të datës 27.11.2020; Shkresën zyrtare të datës 24.11.2020; Shkresën zyrtare të datës 27.11.2020; Shkresën zyrtare të datës 27.11.2020; Shkresën zyrtare të datës 08.11.2021; Shkresën zyrtare të datës 15.11.2021; Shkresën zyrtare të datës 04.11.2021; Shkresën zyrtare të datës 04.11.2021; Shkresën zyrtare të datës 03.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 06.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 28.07.2021; Shkresën zyrtare të datës 12.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 12.05.2021; Shkresën zyrtare të datës 27.06.2021; Shkresën zyrtare të datës 28.07.2021; Shkresën zyrtare të datës 18.05.2021; E-mailin zyrtar të datës 08.12.2021; Emailin zyrtar të datës 13.04.2022; E-mailin zyrtar të datës 20.01.2020; Raportin e prezencës në punë për periudhën prej 20.01.2022-31.01.2022 për ankuesen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa lejuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, ka konstatuar se: ndaj ankuese: vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021, nga Udhëheqësja e saj e drejtpërdrejtë është bërë me datën 26.01.2022. Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 ankuesja e kishte pranuar pas prezencës në punë me datën 31.01.2022, pasi që e njëjta në këtë periudhë kishte qenë në izolim sepse kishte rezultuar me covid ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datën 04.03.2022, e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve , nga data kur është njoftuar për aktin administrativ"*, andaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankueses është e pa lejuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.210/2022, datë 15.04.2022

Ardita PERÇUKU-SHYTI



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

